

## Specifikime Teknike

1. Punimet e hidro-izolimit do të kryhen në pjesën e verandës të Shtëpisë së Fëmijëve si dhe në taracën e hollit të katit të tretë.  
Hidroizolimi në pjesën e verandës do të kryhet në faqen ku komunikohet me hollin (dhomën e ndenjies). Në këtë pozicion ndodhet shkarkuesi i u/shiut të catisë i cili është i dëmtuar. Shkarkuesi do të hiqet nga ai pozicion duke u spostuar në lartësi nën strehë, dhe vrima e mbetur si dhe e gjithë faqja e hollit do të izolohen në një lartësi jo më pak se 1m nga dyshemeja si dhe 1m në dysheme për tu mbivendosur në izolimin egzistues. Shtresat izoluese do të jenë dy duar katrama, soleta do të pastrohet, do të lahet dhe më pas do të lyhet me bitum + shtresat e katramasë. E njëjta gjë do të kryhet edhe në taracën e hollit.
2. Shkarkuesi horizontal i u/shiut të catisë është tub pvc dhe jo ulluk cka krijon bllokime të vazhdueshme, ky tub duhet të pastrohet nga mbetjet dhe bllokimet e mundshme. Tubi i shkarkimit të u/sh me shkarkim sipër menxës është i thyer tërësisht. Pozicioni aktual i tij është në dysheme duke rrezikuar vazhdimisht dëmtimin. Ky segment do të hiqet dhe do të zëvendësohet me tub Ø200mm pvc me spesor të trashë për linja të jashtme dhe pozicionimi i tij do të jetë nën strehën e hollit për të shmangur dëmtimet në të ardhmen.
3. Ndriculesat tavanor do të jenë të tipit neon 2x36ë sejcili me llampë të drejtë dhe me xham mbrojtës. Ndriculesat do të montohen në menxën e Shtëpisë së Fëmijës në pjesën e tavanit.
4. Disa prej dyerve dhe dritareve të aluminit në ambjentin e menxës dhe dhomave të cunave janë të dëmtuara ose amortizuar nga puna. Këto dyer dhe dritare kanë nevojë për regjistrim, riparim doreza etj. dhe do të kthehen në gjendje funksionale.
5. Lavamani profesional do të jetë inox me dy govata të mëdha për të mundësuar futjen e kazanëve dhe kusive të gatimit. Lavamani do të jetë i pajisur me mishelator të ngritur dhe të lëvizshëm si dhe me aksesorët e shkarkimit të ujit.
6. Bolieri 80lit do të montohet në pjesën e kuzhinës.
7. Në ambjentin e menxës ka dëmtime në veshjen anësore me pllaka, pllakat e dëmtuara do të hiqen dhe do të zëvendësohen me të reja me ngjyrë dhe madhësi të njëjtë.

8. Dollapët e dhomave të djemëve do të jenë me material MDF dhe me lyerje të punuara me cilësi. Gjithashtu dollapët do të jenë të ndarë në tre seksione dhe sejcili seksion do të ketë mbyllje me celës.
9. Dyert e aluminit do të vendosen në dhomat e katit të dytë (dhomat e djemve) do të jenë me përmasa 0.8x2.1m me material të rëndë dhe pa hapësirë xhami, bllok alumini pa xham.
10. Lyerja do të bëhet me dy duar bojë cilësi I hidroplastike Inporti në mjediset e katit të dytë (dhomat e djemëve dhe koridor).
11. Në dhomat e djemëve dhe koridori do të ndërrohen pjesërisht pllakat e dyshemesë (zonat e dëmtuara). Pllakat do të jenë porcelanat inporti dhe do të kombinojnë në ngjyrë dhe madhësi me ato egzistueset.

